




Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivry	10.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP1784CK	1288/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.89/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë,si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.89/2022 të datës 02.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër 01/135 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 10.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.89/2022 e datës 02.02.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01/135 i datës 31.01.2022 i Kryetarit të Komunës së Malishevës.

A r s y e t i m

Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme në Komunën e Malishevës më datë 28.01.2020 ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës që qoftë përmes konkursit apo ricaktimit të caktoni një punëtor në Zyrën e Pranimit për shkak të kërkesave të shumta nga qytetarët.

Kryetari i Komunës së Malishevës, më datë 31.01.2022 ka nxjerr Vendim me numër 01/135 më të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita "Inspektor i Komunikacionit" në pozitën "Zyrtar për Shërbime me Qytetarë" në Zyrën e Pritjes, me gradë dhe koeficient të njëjtë me efekt juridik nga data 01.02.2022.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër 01/135 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, fizikisht më datë 02.02.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. prot:496/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunën e Malishevës. Më datë 18.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Malishevës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.02.2022 me Nr. Prot:496/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01/135 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës; Letërnjoftimin e ankuesit; Akt Emërimit të datës 04.01.2012 në emër të ankuesit; Vërtetimin e datës 01.02.2022; Diplomën e datës 30.03.2009 të ankuesit; Kërkesën e datës 28.01.2022 të Drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme; Index në emër të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 18.02.2022; Katalogun e vendeve të punës në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, **është e pabazuar sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 04.01.2012 është i punësuar në pozitën "Inspektor i Komunikacionit" në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Malishevës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 01/135 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, pretendon që me këtë vendim është degraduar sepse pozita Zyrtar për Shërbim me Qytetar është pozitë me e ultë se pozita Inspektor i Komunikacionit dhe për këtë pozitë kërkohet kualifikim i shkollës së mesëm; Janë shkelur procedurat e nenit 52 të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Bazuar në përshkrimin e detyrave të punës, respektivisht Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, po ashtu edhe duke i'u referuar Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pozita Zyrtar për Shërbim me Qytetar hyn në kuadër të grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm ku kërkohet Arsimim i Lartë i Paspacificuar, po ashtu sipas nenit 33 paragrafit 1 dhe 2 nën paragrafit 2.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë përcaktuar që: **"Pozitat në Shërbimin Civil grupohen sipas kategorisë, klasës dhe natyrës së pozitës. 2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.4. Kategoria profesionale, që**

përfshin zyrtarët profesionalë”, bazuar në këtë pozita Inspektor i Komunikacionit dhe pozita Zyrtar për Shërbim me Qytetar, hyjnë në kuadër të kategorisë së pozitave profesionale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, referuar provave të lëndës dhe dispozitave ligjore në fuqi, konstaton se kur institucioni vlerëson që është e nevojshme dhe për interes të institucionit mund të bëhet transferim i përkohshëm i nëpunësve civil, brenda të njëjtës kategori dhe gjatë dy viteve jo më shumë se gjashtë muaj siç parashihet me dispozitat e nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili nënkupton që: *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”.*

Bazuar në kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Malishevës të datës 28.01.2020 parashtruar Kryetarit të Komunës së Malishevës më të cilën ka kërkuar që çoftë përmes konkursit apo ricaktimit të caktoni një punëtor në Zyrën e Pranimi për shkak të kërkesave të shumta nga qytetarët, atëherë institucioni duke e parë të arsyeshme këtë nevojë ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita “Inspektor i Komunikacionit” në pozitën “Zyrtar për Shërbime me Qytetarë”, në pajtim me nenin 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 5 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse në bazë të Vendimit me numër 01/135 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, ankuesi përkohësisht është transferuar në kategori të njëjtë dhe me koeficient të njëjtë, andaj sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pretendimi ankimor i ankuesit e me këtë vendim është degraduar sepse pozita Zyrtar për Shërbim me Qytetar është pozitë me e ultë se pozita Inspektor i Komunikacionit dhe për këtë pozitë kërkohet kualifikim i shkollës së mesëm, është i pabazuar.

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur dhe nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil, siç parashihet me nenin 52 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, i cili përcakton se: *“Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit”,* në këtë rast nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për refuzim të transferimit nga ana e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër 01/135 i datës 31.01.2022 i Kryetarit të Komunës së Malishevës, për transferimin e përkohshëm përveç që është në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, është në përputhje me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit se janë shkelur procedurat e nenit 52 të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse në Vendimin me numër 01/135 i datës 31.01.2022 i Kryetarit të Komunës së Malishevës për transferimin e



përkohshëm të ankuesit është përcaktuar transferim bëhet deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve, atëherë pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme siç parashihet me nenin 52 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.89/2022, më datë 10.03.2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

